



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGISË
BORDI

VENDIM

Nr. 153, Datë 13.06.2022

MBI

**DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË
KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË “HEC-I KABASH
POROCAN” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 5, nenit 7 dhe nenit 9, pikat 4 dhe 5, dhe nenit 10 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.06.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 910/2 prot., datë 10.06.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “HEC-I KABASH POROCAN” sh.p.k.”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “HEC-i KABASH POROCAN” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 93, datë 28.07.2015 si dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 94, datë 28.07.2015.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 196/1 prot., datë 17.02.2022, shoqëria ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit për ndryshimin e ortakut kryesor të saj, nëpërmjet shitjes së 100% të kuotave nga shoqëria “ERPA INVEST” sh.p.k. te shoqëria “DUFERCO ALBANIA” sh.p.k.. ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 196/2 prot., datë 04.03.2022, duke i evidentuar dokumentacionin e munguar. Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 196/3 prot., datë 07.04.2022, shoqëria ka depozituar informacion dhe dokumentacion, i cili rezultoi i paplotë përsëri. Duke marrë në konsideratë faktin që shoqëria nuk ishte plotësisht e qartë në lidhje me dokumentacionin e këtij aplikimi, ERE i dërgoi shkresën vijuese nr. 196/5 prot., datë 18.05.2022. Shoqëria me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 196/6 prot., datë 23.05.2022 dhe nr. 196/9 prot., datë 10.06.2022, ka depozituar të gjithë dokumentacionin e kërkuar.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “HEC-I KABASH POROCAN” sh.p.k. rezulton se ajo ka plotësuar tërësisht kërkesat “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, si vijon:
 - Paraqitja e kërkesës - neni 5, pika 2, 4 dhe 5.
 - Përmbajta e kërkesës dhe dokumentacioni i nevojshëm për dhënien e autorizimit nga ERE - neni 7, pika 1, gërmat a), b), c), d), e), f), g), pika 2, gërmat a), b), c), ç), d), e), f).
- Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor, nuk e çliron shoqërinë “HEC-i KABASH POROCAN” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera për këtë transferim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
- Shoqëria “HEC-I KABASH POROCAN” sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s për sa i përket pagesave të rregullimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “HEC-i KABASH POROCAN” sh.p.k..
2. Ortaku i vetëm i shoqërisë “HEC-i KABASH POROCAN” sh.p.k. bëhet shoqëria “DUFERCO ALBANIA” sh.p.k..
3. Shoqëria “HEC-I KABASH POROCAN” sh.p.k. të njoftojë ERE-n për bërjen efektive të këtij transferimi, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi.
4. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor, nuk e çliron shoqërinë “HEC-i KABASH POROCAN” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera për këtë transferim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI